

SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHËSHME

PROFILI NATYROR

**PJESA I
LETËRSI**

ISMAIL KADARE: KRISTAL

Ka kohë që s' shihemi dhe ndiej
Si të harroj un' dalngadal,
Si vdes tek unë kujtimi yt
Si vdesin flokët dhe gjithçka.

Tani kërkuj unë posht' e lart
Një vend ku ty të të lëshoj.
Një strofë a notë, a një brilant
Ku të të lë, të puth, të shkoj.

Në s' të pranofte asnjë varr
Asnjë mermer a morg kristal,
Mos duhet vall' prap të të mbart
Gjysmë të vdekur, gjysmë të gjallë?

Në s' gjetsha hon ku të të hedh
Të gjej një fushë a një lulënjë
Ku butësisht porsin polen
Gjithkund, gjithkund të të shpërndaj.

Të të mashtroj ndoshta kështu
Dhe të të puth e t' ik pa kthim.
Dhe nuk do dimë as ne, askush
Harrim ish ky a s' ish harrim.

Matura Shtetërore 2006, Teste

Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë.

1. Kjo poezi bën pjesë në lirikën: **1 pikë**
A) filozofike.
B) të natyrës.
C) intime.
D) shoqërore.
2. Prej dashurisë që nuk është më, heroi lirik ndahet me: **1 pikë**
A) delikatesë dhe dhimbje.
B) ftohtësi dhe mospërfillje.
C) brutalitet dhe zemërim.
D) lot dhe ankime.
3. Atë çfarë përcjell kjo poezi te lexuesi është se: **1 pikë**
A) dashuria e humbur duhet harruar.
B) asnjë dashuri nuk humbet.
C) një dashuri është si gjithë të tjerat, zëvendësohet shpejt.
D) dashuria e humbur zëvendësohet me shpërfillje.
4. Ndjenja që zotëron në këtë poezi është: **1 pikë**
A) ironia.
B) urrejtja.
C) zhgënjimi.
D) nostalgjia.
5. Kjo poezi është shkruar me varg: **1 pikë**
A) 6 - rrokësh.
B) 8 - rrokësh.
C) 10 - rrokësh.
D) 12 - rrokësh.
6. Pse autori ka vënë në titull të poezisë metaforën *kristal*? Gjej disa nga ngjashmëritë fizike, estetike etj. ndërmjet kristalit dhe dashurisë së humbur. Shkruaj mendimin që të lind nga krahasimi i saj me këtë gur të çmuar. **4 pikë**

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

7. Rendit tre tipare të lirikës erotike të Kadaresë, duke u ndalur në poezinë e mësipërme si dhe duke patur parasysh krijimtarinë poetike të autorit. **3 pikë**
- a. _____
- b. _____
- c. _____
8. Gjej detajet që duket sikur vizatojnë peizazhin e shpirtit të heroit lirik. Si do ta përcaktoje një shpirt të tillë: të bukur, të trazuar, të pakuptueshëm, të pasur, të dyshimtë, ...? Shpreh mendimin tënd duke shfrytëzuar detajet që gjete. **4 pikë**
9. Cilën nga fjalët e poezisë do të vendosje menjëherë pas fjalëve *hon* dhe *hedh*, duke pasur parasysh aliteracionin me shkronjën *h*? Ç'efekt krijon përmendja e menjëhershme pas tyre e fjalës *lulënjë*? Argumento mendimin tënd. **3 pikë**
10. Lexo me vëmendje dy vargjet e para të strofës së fundit. Si e kupton vargun *Dhe të të puth e t'ik pa kthim*? Në cilën prej dy fjalëve - kyç gjejmë të fshehur dhimbjen? Shpreh mendimin tënd në formën e një eseje argumentuese. **6 pikë**